

FUSHATA PËR
DREJTËSI
NDËRKOMBËTARE



KOSOVA

ENDE TË ZHDUKUR PAS
GJITHË KËTYRE VITEVE

**AMNESTY
INTERNATIONAL**



“Sikur ta dija ku është tani djali im, Albioni, dhe sikur të mundesha ta varros e t’i vendos një lule tek varri, do të ndihesha shumë më mirë.”

Nesrete Kumnova, 2011

Rreth 3600 persona u zhdukën ose rrëmbyen në Kosovë gjatë konfliktit të armatosur të viteve 1998-9 dhe në periudhën menjëherë pas tij. Trembëdhjetë vjet më vonë, rreth 1797 persona janë ende të pagjetur. Familjet e tyre ende jetojnë me shpresën që një ditë mbetjet e tyre mortore do të gjenden dhe se do të mund të varrosin eshtrat e familjarëve të tyre.

Që nga viti 1999 janë gjetur, identifikuar, dhe u janë kthyer familjeve të tyre për t’i varrosur, mbetjet mortore të rreth 1800 personave të regjistruar si të zhdukur. Por pak autorë të këtyre krimeve janë nxjerrë para drejtësisë dhe, në pjesën më të madhe të rasteve, familjarët e të zhdukurve ende nuk e dinë se kush i ka varrë ata.

Në dhjetor të vitit 2008, EULEX-i, Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit, u ngarkua me hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e krimeve të luftës në Kosovë. Më parë kjo ishte përgjegjësi e Administratës së Përkohshme të KB-së për Kosovën (UNMIK).

Që prej asaj kohe, hetimet janë kryer nga policia dhe prokurorët ndërkombëtarë të

EULEX-it, dhe çdo procedim penal që ka rezultuar prej tyre, është gjykuar nga një panel i përbërë nga gjykatës ndërkombëtarë dhe të Kosovës. EULEX-i ka bërë përpertime të rëndësishme, përfshirë fillimin e hetimeve të disa rasteve të zhdukjeve me forcë për të cilat Amnesty International ka bërë fushatë që prej vitit 1999. Por shumica dërrmuese e rasteve nuk janë hetuar, dhe të afërmit ende presin për drejtësi.

KUSH JANË TË ZHDUKURIT?

Rreth 3000 shqiptarë të Kosovës qenë viktima të zhdukjeve me forcë nga forcat ushtarake, policore dhe paramilitare serbe. Po kështu, disa shqiptarë të Kosovës, të akuzuar si tradhtarë ose se kishin lidhje me serbët, pretendohet se janë rrëmbyer nga pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). (Amnesty International bën dallim midis zhdukjeve me forcë – në të cilat përfshihen drejtpërsëdrejti ose tërthorazi agjentët shtetërorë – nga rrëmbimet e kryera prej aktorëve jo-shtetërorë, si grupet e armatosura të opozitës, për shembull UÇK-ja, përveç rasteve kur edhe ato përbëjnë krime kundër njerëzimit, siç shpjegohet më poshtë.)



Gjatë luftës, dhe sidomos në periudhën menjëherë pas konfliktit të armatosur ndërkombëtar më 10 qershor 1999, pretendohet se rreth 600 serbë, romë, dhe pjesëtarë të komuniteteve të tjera të pakicës, janë rrëmbyer nga UÇK-ja.

Pjesa më e madhe e të të zhdukurve – shqiptarë, serbë, romë, dhe të tjerë – ishin civilë. Ata ishin njerëz të zakonshëm të cilët, për shkak të kombësisë së tyre, u morën nga shtëpitë ose nga rruga, dhe më vonë u vranë. Ndër ta kishte edhe fëmijë, dhe të moshuar. Pjesa më e madhe ishin meshkuj, por midis tyre kishte edhe disa gra e vajza. Familjarët e tyre kanë pritur me vite që t’u kthehen trupat e tyre, dhe vazhdojnë të presin për drejtësi.

Majtas: Një arkeologe forensike EULEX-it (majtas), që punon për Departamentin e Mjekësisë Ligjore, udhëzon pjesëtarët e ekipit vendor të zhvarrimeve, 2011.



LUTFI DHE BEKIM BUNJAKU



Floza Bunjaku është nëna e Bekim Bunjakut dhe bashkëshortja e Lutfi (Enver) Bunjakut, që ishin respektivisht 15 vjeç dhe 47 vjeç kur u zhdukën në vitin 1999. Ajo i tha Amnesty International:

“I kam treguar policisë së UNMIK-ut për rastin në vitin 2000, I kam treguar njësisë së krimeve të luftës ... faktin e rëndësishëm se e njihja policin serb që m’i ka marrë djalin dhe burrin ... Ua kam dhënë atyre adresën dhe numrin e kartës së identitetit të tij.

“Ju lutem na ndihmoni t’i zgjidhim këto çështje deri në fund, jo si UNMIK-u, që nuk zgjidhi asgjë ... Unë do t’ju jap emrin e policit që ka marrë burrin dhe djalin tim. Ai duhet t’ju thotë se çfarë ka bërë me ta, dhe si i ka vrarë. Ai është në Serbi. Kërkoj që të gjithë ata që janë përgjegjës për krime të dalin para drejtësisë, nëse ligji ekziston.”

PSE ËSHTË VONUAR DREJTËSIA?

Nga viti 1999 deri më 2008, policia dhe drejtësia e Kosovës drejtohej nga UNMIK-u. Megjithatë, policia ndërkombëtare e UNMIK-ut nuk i filloi hetimet e menjëhershme në bazë të kallëzimeve të familjarëve të të zhdukurve. Policia dhe prokurorët e UNMIK-ut nuk i kanë shqyrtuar fare disa raste, ndonjë herë edhe qëllimisht nuk është bërë mbledhja e provave, ose provat e mbledhura u kanë humbur. Edhe forca e Kosovës (KFOR), e udhëhequr nga NATO, ka marrë me qindra raportime nga familjarët e të pagjeturve, që nuk i janë dorëzuar policisë ndërkombëtare. Janë kryer shumë pak hetime efektive, dhe shumë pak autorë të krimeve janë sjellë para drejtësisë.

“Ju lutem na ndihmoni t’i zgjidhim këto çështje deri në fund, jo si UNMIK-u”

Floza Bunjaku, nëna e Bekim Bunjakut dhe bashkëshortja e Lutfi (Enver) Bunjakut.

“Ne të gjithë e dimë se kush na i ka marrë familjarët. Janë 30 familje që duhen intervistuar; unë jam një prej gjashtë personave që mbijetuan.”

Agron Limani, Tetor 2011

KRUSHË E VOGËL

Agron Limani bisedoi me Amnesty International në tetor të vitit 2011. Ai tha se kishte marrë lajme të mira: “Dy javë më parë, dy policë të Kosovës [nga Njësia e Hetimit të Krimeve të Luftës e EULEX-it] më kanë thënë se duan të mbledhin informacion për masakrën në Krushë e Vogël, dhe u habita. I thashë, çfarë po më dëgjojnë veshët? Për herë të parë në 12 vjet?”

Agron është një prej gjashtë të mbijetuarve nga një vrasje masive në fshatin Krushë e Vogël në vitin 1999. Ai i tha Amnesty International: “Ata më thanë se donin të takoheshin me përfaqësues të fshatit dhe të merrnin disa detaje shkurtimisht për secilin rast për t’ia çuar prokurorit, dhe pastaj prokurori do të vijë dhe do t’i intervistojë të gjithë. Kështu që ne e planifikuam si ta bëjmë këtë. Ka ndodhur gjëja më e madhe. Ne e dimë të gjithë se kush na i ka marrë familjarët. Ka 30 familje që duhen intervistuar; unë jam një prej gjashtë personave që mbijetuan”.

A DO TË SJELLË DREJTËSI EULEX-I?

Në dhjetor 2008, EULEX-i mori nga UNMIK-u kompetencat për hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve të luftës. Ata trashëguan prej UNMIK-ut 1187 raste të dyshuara për krime lufte, ndër të cilat edhe raste të zhdukjeve dhe rrëmbimeve me forcë. Më se 300 prej këtyre rasteve u mbyllën për mungesë provash, të cilat ose nuk ishin mbledhur menjëherë, ose nuk ishin mbledhur siç duhet nga paraardhësit e EULEX-it. Në shtator të vitit 2009, më se 850 raste ishin ende pa u hetuar dhe ndjekur penalisht.

Në qershor të vitit 2011 numri i rasteve të krimeve të luftës që po hetoheshin nga policia dhe prokuroria e EULEX-it ishte më pak se 60. Sipas Njesisë së Hetimit të Krimeve të Luftës së Policisë së EULEX-it, ata kanë burime dhe personel të mjaftueshëm për të bërë mesatarisht tre hetime në vit.



© Agron Limani

GJETJA E MBETJEVE MORTORE

Deri në mars të vitit 2012 janë gjetur më shumë se gjysma e mbetjeve mortore të shqiptarëve të Kosovës të zhdukur nga forcat serbe.

Në muajt prill dhe maj të vitit 1999, punonjësit e Ministrisë së Brendshme të Serbisë zhvarrosën dhe bartën në Serbi mbetjet mortore të shqiptarëve të Kosovës, të vrarë dhe varrosur nga forcat serbe dhe u rivarrosën. Në total, në Serbi janë zhvarrosur nga varre masive ose individuale mbetjet mortore të të paktën 900 personave të vrarë në Kosovë. Pjesa më e madhe e mbetjeve mortore të identifikuar u janë kthyer familjarëve për t’i varrosur.

Rreth 700 deri në 800 mbetje mortore të shqiptarëve të Kosovës ende nuk janë gjetur. Disa janë varrosur në Kosovë; disa besohet se janë varrosur në Rashkë të Serbisë jugore. Nga gërmimet në atë vend deri më tani nuk është zbuluar ndonjë provë. Të tjerë nuk kanë për t’u gjetur kurrë. Ka prova se trupat e tyre janë djegur në furra për shkrirje metalesh dhe incineratorë në Serbinë jugore.

Majtas: Ri-varrimi në vitin 2007 i burrave të Krushës së Vogël që u vranë në vitin 1999. Vetëm gjashtë burra nga fshati i mbijetuan masakrës.



Amnesty International i ka bërë thirrje Zyrës së Prokurorit të Krimeve të Luftës në Serbi që të fillojë hetimet për punonjësit e policisë së Ministrisë së Brendshme që akuzohen se kanë marrë pjesë në operacionin për fshehjen e trupave të personave me kombësi shqiptare të vrarë në Kosovë, dhe të zbulojnë se ku janë çuar mbetjet mortore të personave me kombësi shqiptare ende të pagjetur.

IDENTIFIKIMI I MBETJEVE MORTORE

Në Kosovë, Departamenti i Mjekësisë Ligjore (DML) luan rol kyç në hetimin e zhdukjeve dhe rrëmbimeve me forcë. DML, që më parë ka qenë Zyra e EULEX-it për Personat e Pagjetur është përgjegjës për identifikimin e vendvarrimeve të mundshme dhe kryerjen e zvarrimeve. DML mbështetet tek ndihma e dëshmitarëve që vijnë dhe u tregojnë se ku gjenden vendvarrime të tilla. DML punon gjithashtu edhe për identifikimin e mbetjeve mortore në bashkëpunim me Komisionin Ndërkombëtar për Personat e Pagjetur, që bën analiza të ADN-së të mbetjeve mortore. DLM organizon kthimin e mbetjeve mortore tek familjet e tyre,

për t'u bërë varrimin. DLM gjithashtu luan një rol kyç në sigurimin e provave për ndjekje penale të krimeve të luftës.

Transferimi i përgjegjësisë të DLM-së nga EULEX-i tek Ministria e Drejtësisë së Kosovës është planifikuar të bëhet në vitin 2012. Amnesty International nxit që ky transferim të shtyhet deri sa të caktohet një personel i mjaftueshëm vendor, i trajnuar. Për shembull, nuk ka specialistë forensikë vendorë që të kenë aftësitë që kërkohen për të bërë zhvarrime komplekse dhe për identifikimin e mbetjeve mortore.

Amnesty International mendon se nuk ka mbështetje të mjaftueshme politike nga qeveria e Kosovës për të siguruar që të gjitha mbetjet mortore, përfshirë edhe ato të serbëve dhe të pakicave të tjera, të trajtohen mbi baza të barabarta dhe të paanshme.

ALBION KUMNOVA

Albion Kumnova nga Gjakova besohet se ka qenë ndër viktimat, trupat e të cilëve u bartën në Serbi, së bashku me pesë shokë të tij.



Më 31 mars 1999, policia serbe u fut me forcë në oborrin e shtëpisë së familjes Kumnova. Gjashtë djem të rinj – të gjithë civilë – u morën me forcë dhe nuk u panë më kurrë të gjallë. Pesë mbetje njerëzore u zvarrosën afër Bajna Bashtës në Serbi në shtator të vitit 2001, dhe iu kthyen familjarëve në shtator të 2005-ës dhe 2006-ës.

Albion Kumnova është ende i regjistruar si i pagjetur nga Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq.

Në vitin 2011, EULEX-i filloi hetimet mbi zhdukjen e tij me forcë. Deri në mars të vitit 2012 trupi i tij nuk është gjetur, e as nuk janë identifikuar policët përgjegjës për zhdukjen e tij me forcë. Nëna e Albionit, Nesrete Kumnova, ende po pret për drejtësi.



PETRIJA PILJEVIQ

Më 28 qershor 1999, Petrija Piljeviq, një 57 vjeçare serbe e Kosovës, u rrëmbye nga apartamenti i saj në Prishtinë nga burra që kishin veshur uniforma të UÇK-së. Një vit më vonë, trupi i saj u zhvarros në një varrezë në Prishtinë, nga një ekip ekspertësh të Tribunalit Penal Ndërkombëtar për Ish-Jugosllavinë. I biri i identifikoi mbetjet mortore të së ëmës nga teshat që kishte veshur.

Trembëdhjetë vjet pas rrëmbimit dhe vrasjes së Petrija Piljeviqit, autorët e krimit ende nuk janë sjellë para drejtësisë. Në vitin 2010, ankesa e të birit se UNMIK-u nuk kishte bërë një hetim efektiv të rrëmbimit të saj u deklarua i pranueshëm nga Paneli Këshillimor për të Drejtat e Njeriut dhe do të merret në shqyrtim në vitin 2012. Djemtë e Petrija Piljeviqit ende po presin drejtësi.



PANELI KËSHILLIMOR PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Moshetimi i rrëmbimeve të serbëve, romëve dhe pakicave të tjera është kundërshtuar nga familjet serbe të Kosovës, shumica e të cilave tani jetojnë në Serbi. Paneli Këshillimor për të Drejtat e Njeriut (PKDNJ) është një organ i pavarur juristësh të njohur ndërkombëtarë që janë ngarkuar me shqyrtimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut nga UNMIK-u. PKDNJ nuk ka kompetenca për të filluar hetime penale, por ka autoritetin t'i bëjë thirrje UNMIK-ut që të rifillojë hetimet.

Në vitin 2011 PKDNJ-ja deklaroi të pranueshme mbi 40 ankesa të bëra nga familjet në Serbi, mbi bazën se UNMIK-u nuk kishte hetuar siç duhet rrëmbimin e familjarëve të tyre. Në shumicën e këtyre rasteve PKDNJ-ja njohu edhe faktin që dhimbja dhe vuajtjet e të afërmeve, të shkaktuara nga mos-hetimi i këtyre rrëmbimeve nga UNMIK-u, shkelte gjithashtu edhe parimin e ndalimit të torturës dhe të keqtrajtimeve apo sjelljeve të tjera çnjerëzore dhe degraduese sipas Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Këto familje ende po presin për drejtësi.

RRËMBIMET E SERBËVE, ROMËVE DHE PAKICAVE TË TJERA

Gjatë dhe pas konfliktit, deri në 600 persona me kombësi serbe, rome dhe pakica të tjera u rrëmbyen dhe u vran. Një pjesë e mirë e tyre prej UÇK-së. Shumë prej mbetjeve të tyre mortore nuk janë gjetur. Kultura mbizotëruese e mosndëshkimit për pjesëtarët e UÇK-së ka bërë që pak dëshmitarë të ofrohen për identifikimin e vendvarrimeve. Pak raste janë hetuar ashtu siç duhet. Amnesty International mendon se kjo klimë mosndëshkimi inkurajohet nga mungesa e vullnetit politik të qeverisë për t'i nxjerrë ish pjesëtarët e UÇK-së para drejtësisë. Sipas standardeve ndërkombëtare dhe Ligjit të Kosovës për Personat e Pagjetur të vitit 2011, familjet e të rrëmbyerve kanë të drejtën të informohen se çfarë i ka ndodhur familjarit të tyre.

Rrëmbimet që kanë ndodhur pas vitit 1999 nuk konsiderohen nga EULEX-i si krime lufte ose krime kundër njerëzimit, dhe as nuk hetohen dhe ndiqen penalisht nga Zyra e Prokurorisë Speciale të Kosovës (ZPSK). Në vitin 2009 ZPSK-ja (e përbërë nga prokurorë ndërkombëtarë dhe vendorë, dhe përgjegjëse për hetimin e krimeve të luftës

Shqiptarë të Kosovës kalojnë pranë shtëpive të shkatërruara në një komunitet rom në Mitrovicë, 25 prill 2006. Popullata rome u detyrua të largohet nga kjo zonë në vitin 1999.



DAKA ASANI

Më 1 gusht 1999, Daka Asani (i njohur edhe si Asanoviq) shkoi me të birin në tregun e Ferizajt në Kosovë, ku edhe banonte. Ai qëndroi më gjatë në treg, sepse donte të shihte rreth e përqark. Sipas një tregtari në treg, Daka Asanin e kishte marrë me veturë një person i paidentifikuar. Shoqja e tij shkoi tek KFOR-i dhe u kërkoi ndihmë. Ata nuk ishin në gjendje ta ndihmonin.



Më 19 gusht 1999 familja i kërkoi Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq në Kosovë që ta gjenin Daka Asani. Më 1 dhjetor 2006 Zyra për Personat e Pagjetur dhe Mjekësi Ligjore e UNMIK-ut e informoi familjen e Daka Asanit se kufoma e tij ishte identifikuar pasi ishte zhvarrosur nga një varr në Prishtinë në vitin 2000. Ai kishte vdekur si rezultat i "plagëve të shumta me plumba në kokë dhe në trup". Trupi i Daka Asanit iu kthye në dhjetor të vitit 2006 vëllait të tij në Serbi. UNMIK-u nuk filloi asnjëherë hetime penale.

Në vitin 2008 Amnesty International i dha UNMIK-ut informacion për një dëshmitar të mundshëm të rrëmbimit, i cili kishte kontaktuar me vëllain e Daka Asanit në Serbi. Me sa di organizata, asnjëherë nuk është filluar ndonjë hetim për rrëmbimin dhe vrasjen e Daka Asanit.

dhe të krimeve të rënda ndëretnike) mori në shqyrtim të gjitha rastet e pazgjidhura që nuk u hetuan asnjëherë në mënyrë efektive nga UNMIK-u. Ajo nuk i rihapi hetimet, por, mbi bazën e asaj se rrëmbimet ndodhën pas mbarimit të konfliktit, ia transferoi 62 raste rrëmbimesh të pretenduara prokurorëve të EULEX-it në zyrat vendore të prokurorive komunale. Që prej asaj kohe pak prej këtyre çështjeve janë hetuar; të tjerat u klasifikuan si krime ordinere. Amnesty International mendon se rrëmbimet që kanë ndodhur pas qershorit 1999, në periudhën menjëherë pas luftës, ishin pjesë e një sulmi të përhapur dhe sistematik mbi një popullatë civile dhe si të tilla, janë krime kundër njerëzimit. Për këtë arsye, ZPSK-ja duhet t'i hetojë dhe ndjekë penalisht gjithë këto rrëmbime si krime kundër njerëzimit.

TASK FORCA E HETIMEVE SPECIALE

Në vitin 2011 EULEX-i ndërmori një hap të rëndësishëm duke emëruar një Task Force të Hetimeve Speciale (TFHS), të drejtuar nga një ish drejtor i Departamentit të Drejtësisë së UNMIK-ut, për të hetuar pretendimet që lidheshin me rrëmbimet e pasluftës në Kosovë.

Ky emërim erdhi si pasojë e protestave ndërkombëtare pas miratimit që i bëri Komiteti Parlamentar i Këshillit të Evropës raportit të senatorit zviceran Dick Marty, i cili pretendonte se pjesëtarë drejtues të UÇK-së, përfshirë kryeministrin e tanishëm Hashim Thaçi, ishin të implikuar në rrëmbimin e serbëve dhe shqiptarëve të Kosovës. Serbët e rrëmbyer pretendohet se janë marrë nga kampe-burgje në Kosovë pas qershorit të vitit 1999 dhe janë çuar në kampe-burgje në Shqipëri. Pretendohet se atje ata janë torturuar dhe shumica e tyre janë vvarë. Të tjerëve pretendohet se u janë hequr organet.

UNMIK-u kishte marrë informacion nga dëshmitarë për këto pretendime në vitin 2003. Informacioni më vonë u raportua nga Kryeprokurorja e Tribunalit Penal Ndërkombëtar për Ish Jugosllavinë, por në atë kohë UNMIK-u nuk filloi një hetim efektiv.

Deri në mars 2012 TFHS kishte raportuar shumë pak përparim, përveç asaj që po analizonte informacione dhe se kishte arritur marrëveshje bashkëpunimi me autoritetet shqiptare, që i mundësonin TFHS të kryente hetime në vend.

Më se 400 familje serbe ende po presin të gjenden mbetjet mortore të familjarëve të tyre. Shumë besojnë se djali, babai apo vëllai i tyre mund të jetë ndër serbët që janë çuar në Shqipëri. Ata ende po presin për drejtësi.

Familjarët e romëve, ashkalive, goranëve, boshnjakëve dhe pakicave të tjera gjithashtu po presin për drejtësi. Shumë romë të Kosovës u rrëmbyen dhe u vranë pas luftës nga UÇK-ja ose shqiptarë të tjerë për shkak se perceptoheshin të kishin lidhje me serbët e Kosovës. Pak hetime janë bërë për këto rrëmbime.

ZYRA E PROKURORIT TË KRIMEVE TË LUFTËS, BEOGRAD

Autoritetet serbe janë përgjegjëse edhe për hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve të luftës që ndodhën në Kosovë.

Disa forca të policisë dhe paramilitarëve serbë, përgjegjës për krime lufte, përfshirë edhe zhdukjet me forcë të shqiptarëve të Kosovës nga forcat serbe, janë ndjekur penalisht dhe për ta janë dhënë dënime nga Dhoma Speciale e Krimeve të Luftës e Gjykatës së Rrethit të Beogradit. Megjithatë,

përparimi në sjelljen e autorëve të këtyre krimeve para drejtësisë ka qenë i ngadalshëm.

Amnesty International e pranon se hetimet e bëra nga EULEX-i në Kosovë, në bashkëpunim me Zyrën e Prokurorit për Krimet e Luftës, kanë sjellë si rezultat disa ndjekje penale në Dhomën Speciale të Krimeve të Luftës, në të cilën kanë dëshmuar dëshmitarë shqiptarë të Kosovës.

MBROJTJA E DËSHMITARËVE

Për familjarët e të pagjeturve nuk do të ketë as drejtësi, e as zbulim të së vërtetës nëse dëshmitarët në Serbi e Kosovë nuk ofrojnë të japin më shumë informacion për vendet se ku janë varrosur viktimat. Nuk do të ketë drejtësi nëse dëshmitarët e zhdukjeve me forcë dhe rrëmbimeve nuk të ndihen të sigurt për t'i dhënë dëshmi hetuesve dhe prokurorëve në Serbi e Kosovë.

Amnesty International u bën thirrje qeverive të Kosovës dhe Serbisë që të thyejnë qarkun e mosdëshkimit dhe të krijojnë një atmosferë të sigurt në të cilën dëshmitarët të mund të dëshmojnë.

ÇFARË DUHET TË BËJË EULEX-I?

Ekziston një nevojë e ngutshme për të hetuar rastet e zhdukjeve dhe rrëmbimeve me forcë: mbetjet mortore të të pagjeturve duhet të gjenden dhe t'u kthehen familjarëve, dhe ata që i vranë duhet të dalin para drejtësisë.

Pa një caktim burimesh dhe punonjësish të mjaftueshëm në EULEX për identifikimin e vendvarrimeve, zhvarrimet dhe hetimet penale, dhe pa mbrojtje efektive të dëshmitarëve, nuk do të ketë drejtësi për të afërmit e të pagjeturve, sidomos në rastet që kanë të bëjnë me rrëmbimet e pretenduara të serbëve, romëve dhe pakicave të tjera nga UÇK-ja.

Në qershor të vitit 2012 Këshilli i Bashkimit Evropian do ta shtyjë mandatin e EULEX-it edhe për dy vite të tjera. Amnesty International nxit institucionet e BE-së dhe shtetet anëtare të BE-së të sigurojnë që t'i japin EULEX-it burimet dhe kapacitetet për të cilat ka nevojë për të garantuar se drejtësia nuk do të vonohet më.



Ky material informativ fushate, shoqëron raportin **Kosovo: Time for EULEX to prioritize war crimes** (Kosova: është koha që EULEX-i t'i japë prioritet krimeve të luftës) (Indeks: EUR 70/004/2012)

Kapaku: Një shqiptar i Kosovës qëndron para murit ku janë shkruar emrat e personave të pagjetur që prej konfliktit të viteve 1998-99 në Kosovë, gjatë Ditës së Personave të Pagjetur në Prishtinë më 27 prill 2011.

© ARMEND NIMANI/AFP/Getty Images

REKOMANDIME

Amnesty International nxit Këshillin e Bashkimit Evropian që t'i japë mandat EULEX-it:

- T'i japë prioritet hetimit dhe ndjekjes penale të rasteve të pashqyrtuara të krimeve të luftës;
- Të shtojë numrin e policëve, prokurorëve dhe gjyqtarëve ndërkombëtarë të krimeve të luftës në EULEX;
- Të sigurojë që Departamenti i Mjekësisë Ligjore të ketë personel profesional dhe burime të mjaftueshme për gjetjen e mbetjeve mortore të të pagjeturve;
- Të sigurojë hetimin dhe ndjekjen penale të personave përgjegjës për rrëmbimet e pasluftës të serbëve, romëve, dhe pakicave të tjera;
- Të sigurojë hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve të luftës, të përdhunimit dhe formave të tjera të dhunës seksuale;
- Të krijojë, me ndihmën e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, një program efektiv ndërkombëtar për mbrojtjen e dëshmitarëve;
- Të krijojë një organ të pavarur dhe të paanshëm me prokurorë vendorë që të hetojnë dhe ndjekin penalisht krimet e luftës;
- Të shohë mundësitë për hetimin dhe ndjekjen penale në të ardhmen, të krimeve të luftës në Kosovë, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë së Kosovës dhe organe të tjera, si pjesë e strategjisë së përfundimit të misionit të EULEX-it.

Amnesty International është një lëvizje globale me mbi 3 milion përkrahës, anëtarë dhe aktivistë në më shumë se 150 vende dhe territore të botës që bëjnë fushatë për t'i dhënë fund abuzimeve të rënda të të drejtave të njeriut.

Vizioni ynë është që gjithsecili të gëzojë të gjitha të drejtat e mbrojtura nga Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut dhe standarde të tjera të të drejtave të njeriut.

Ne jemi të pavarur nga çdo lloj qeverie, ideologjie politike, interesi ekonomik apo besimi fetar – dhe mbështetemi financiarisht kryesisht nga anëtarët dhe donacionet publike.

Indeks: EUR 70/005/2012
Albanian

prill 2012

Amnesty International
International Secretariat
Peter Benenson House
1 Easton Street
London WC1X 0DW
United Kingdom

amnesty.org

AMNESTY
INTERNATIONAL

